

Raport Preliminar lidhur me zbulimet në Prishtinë, në sheshin Dr. Ibrahim Rugova

Bashkëpunëtorët e Institutit Arkeologjik të Kosovës në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve dhe Muzeun Rajonal të Prishtinës që tri ditë me radhë, që nga data 27.04. 2012 deri më datën 29. 04. 2012, kanë kryer gjurmime arkeologjike në sheshin Dr. Ibrahim Rugova në Prishtinë, përkatësisht pranë Teatrit Kombëtar të Kosovës, ku janë zbuluar dy objekte, një çezme dhe një bazament (themele) të një objekti të arkitekturës.

Çezma ka trajtë drejtkëndëshi. Është e orientuar verilindje – jugperëndim. Ishte e murosur me gurë të lidhur me llaç gëlqereje të bardhë. Në pjesën jugperëndimore ngrihej govata si pjesë përbërëse e kroit. Kroi ka formë katërkëndësh me dimensione: lartesi 0.76 m, gjerësi 0.80m dhe gjatësi 1.33m. Govata ka formë të gjysëm rrethit me këto dimensione: 1.10m x 0.50m. Në anën juglindore dhe në atë veriperëndimore ka qene i veshur me pllaka mermeri. Govata është ngritur me pllaka gurësh të varreve të ripërdorura (spolie), disa prej të cilave ruaje mbishkrime epitafesh të shkruara në alfabetin arab, sikurse edhe zbukurime me motive bimorë etj. Sipas pllakës së përforcuar të govatës në anën e poshtme, me llaç çimentoje mund të gjykojmë që kroi është ngritur në gjysmën e parë të shekullit XX. , dhe paraqet njërin nga dhjetëra krojet publike të qytetit të Prishtinës. Po ashtu vlen të veçohet që pranë kroit u gjeten edhe copa gurësh plastik mermeri (pjesë varresh), të zvarritur e të dëmtuar gjatë viteve 50 – ta të shekullit XX.